



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 407, Datë 17.12.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 166, 168 pika 2, 189 germa “c” dhe 190 pika 4 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI
GENT IBRAHIMI